



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

VENDIM

NDËRPRITET procedura për lëndën me numër 09-824/1 me datë 27.02.2019, sepse në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për caktimit e përgjegjësisë së personit , Drejtor i SHF ”.....” f. Sipas parashtruesit, drejtori i shkollës së njëjtë ka punësuar persona nga famlja e vet dhe atë: vëllaun, vajzën, djalin e vëllaut dhe dhëndrin e vajzës së tij.

Me qëllim të caktimit të gjendjes faktike, përshkak se në denoncimin anonim nuk ka pasur akuza për persona të afërt me drejtorin, me emër dhe mbiemër, të cilët janë punësuar në shkollën fillore, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek ShF dhe i kërkoi këto dokumenta:

- Listë të të punësuarve në SHFK..... pas emërimit të drejtorit

Nga inspektimi në dokumentacionit e dorëzuar Komisioni shtetëror e caktoi këtë: në periudhën pas emërimit për drejtor personi , gjegjesisht nga data 14.11.2016 në SHF..... janë punësuar tetë persona, dhe atë: arsimtarë lënde, rojë, arsimtarë i gjeografisë, arsimtarë i etikës së religjionit, pastrues, arsimtarë lënde, arsimtarë lënde dhe sekretarë. Për të gjitha personat e përmendur janë dorëzuar kopje nga dokumentacioni i plotë në lidhje me procedurën e punësimit. Më pas është dorëzuar dhe Deklarata nga data 30.03.2029 e vuloura në noter, të dhënë nga ana e Drejtortit në të cilën thuhet se Deklarata e dhënë përshkak të dyshimeve për nepozitën në institucionin në të cilin është i punësuar. Në deklaratë thuhet: në periudhën derisa personi i njëjtë është drejtor i SHF, me gjashtë persona që janë punësuar me asnjërin nga ato nuk ka asnjë lidhje farefisnore. Kurse kur bëhet fjalë për personat (nip i drejtorit), personi i njëjtë është pranuar si arsimtarë i gjeografisë me Konkurs publik nëpërmete BPRM për punë urgjente, në të cilën kanë qenë paraqitur dy persona dhe atë: i cili ka pasur të mbaruar fakultetin përkatës dhe personi (ish arsimtarë i gjeografisë në shkollë nga viti 2012) i cili ende nuk ka të mbaruar fakultetin dhe në BPRM është i paraqitur me shkollë të mesme. Duke pasë parasysh se në konkurs është paraqitur një kandidat me arsimim adekuat, është zgjedhur kandidati me datë 04.09.2017. Në lidhje me punësimin konkret, është bërë inspektim nga ane e Inspektoratit shtetëror të arsimit sipas të cilit nuk është konstatuar lëndim i procedurës. Nga dokumentacioni i dorëzuar, sipas Procesverbalit të Këshillit të shkollës, në lidhje me punësimin në këtë konkurs, anëtarët kanë votuar të barabartë për punësimin e dy kandidatëve, 4-4 dhe kanë dhënë vërejtje të vendos drejtori i shkollës.

Në lidhje me punësimin e personit në vendin e punës sekretar, në deklaratën e cila është dhënë në noter nga ana e drejtorit qëndron se personi i njëjtë është dhëndërr i drejtorit (bashkëshorti i vajzës së tij) dhe është i punësuar me datë 23.11.2019, nëpërmjet Agjensiomit për administratë e Konkurs publik 272/2018 shpallur me datë 14.11.2018. Në këtë Konkurs publik janë paraqitur gjithsej 9 kandidatë, kurse në të gjitha katër fazat kanë kaluar 2 kandidatë: një kandidat ka qenë nga nacionaliteti shqiptarë kurse tjetra nga nacionaliteti maqedonas (.....). Kandidati i rrefuzuar është ankuar deri në organin e shkallës së dytë, pastaj Drejtori thekson se sipas Konkursit publik për vendin e punës kanë kërkuar përfaqësuar të nacionalitetit shqiptarë, në përputhje me balansuesin e miratuar nga MSHIA. Si kandidat që është dorëzuar nga Agjensioni për administratë ka qenë personi pastaj theksohet se asnjë nuk ka dashur të nënshkruan Vendim për zgjedhje të sekretarit të shkollës, me akuza "frikë nga pasojat eventuale në të ardhmen". Gjithashtu, Drejtori thekson se ai nuk është drejtuar të kërkon mendim për konflikt të interesave nga Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, sepse Lista e propozuar nga Agjensioni për administratë është marrë me datë 27.12.2018, prandaj ka menduar se përshkak të festave të fundviti, do të lëshohet afati prej pesë ditë të cilin e ka personi udhëheqës që ta nënshkruan marrëveshjen për punësim, në përputhje me nenin 46 paragrafi 1 nga Ligji për nënpunës administrativ. Shkolla nuk ka pasur zëvendës-drejtor me të drejtë nënshkrimi dhe siç theksohet në deklaratë e dhënë para noterit, asnjë nuk ka pranuar ta nënshkruan vendimin.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar për punësim të personit në vendin e punës Sekretar i shkollës – në të gjitha fazat kanë kaluar dy kandidatë, sipas konkursit të shpallur është kërkuar përfaqësues të nacionalitetit shqiptar në vendin e punës Sekretar. Personi ka qenë i ranguar i dytë sipas Rang listët përfundimtare nga AA me 65,69 pikë të fituara kurse i ranguar i parë ka fituar 67.91 pikë. Komisioni për selektim si propozim kandidat për punësim e ka propozuar të ranguarin e dytë, sepse sipas Konkursit është kërkuar person nga nacionaliteti shqiptarë që ta plotëson pozicionin adekuat të punës. Kandidati i rrefuzuar ka dorëzuar Ankesa deri te Komisioni i Agjensionit për administratë për procesim të ankesës dhe parashtresës të nënpunësve administrativ të shkallës së dytë kundër Vendimit për zgjedhje të kandidatit nëpërmjet Konkursit publik nr. me datë 28.12.2018 miratua nga Drejtori i SHF Komisioni i Agjensionit për administratë për ankesa dhe parashtresa të nënpunësve administrativ të shkallës së dytë ka vendosur se Drejtori i SHF ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për nënpunës administrativ.

Kontrata për punësim në kohë të pacaktuar për personi, është nënshkrua nga drejtori

Në shtojcën e dokumentacionit të dorëzuar është Deklarata e vulosur në noter nga personi, në atë kohë i punësuar si arsimatër në shkollë, sipas të cilës Deklarata me datë 26.12.2018, ka qenë në vizitë të shkollës dhe të drejtorit ka qenë i informuar për procedurën për punësim të sekretarit, drejtori i shkollës ka qenë informuar për procedurën e punësimit të sekretarit, drejtori i shkollës ka kërkuar nga ai që të autorizon për nënshkrim të vendimit për zgjedhje të kandidatit të propozuar nga Agjensioni për administratë, mirëpo personi nuk ka pranuar, sepse nëse qëndron emri dhe

mbiemri i tij në Vendimin, gjoja me mundësi se do të ketë pasoja për atë. Personi i njëjtë deklaroi se në atë periudhë asnjë person nuk ka pranuar ta nënshkruan vendimin.

Në dokumentacionin e dorëzuar dhe Deklaratën nga Kryetari i Këshillit të shkollës në SHF, sipas të cilës drejtori i shkollës ka kërkuar që procedura për punësim të sekretarit të bisedohet edhe në Këshillin e shkollës. I njëjti mendon se organi më i lartë – Agjensioni për adminstartorë ka vendosur për këtë procedurë dhe Këshilli i shkollës i jep pëlqim Drejtorit që ta nënshkruan vendimin.

Komisioni shtetëror duke vepruar për akuzat nga denoncimi e merr parasyshë dokumentacionin e dorëzuar në lidhje e procedurën për punësim në Shkollë, si dhe të gjitha akuzat e theksuara nga ana e Drejtorit dhënë në Deklaratën e vulosur në noter. Në bazë të kësaj ka konstatuar se Drejtori i SHF ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit për parandalim të konflikti të interesave i cili ka vlejte në atë kohë, i cili tashmë nuk vlen, mirëpo dispozitat që kanë të bëjnë me tërheqje janë të shkruara në nenin 75 paragrafi 1 nga Ligji i ri për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, me atë që nuk janë tërhequr për pjesëmarrje në procedurë, gjegjësisht nga nënshkrimi i kontratës për punësim të nipit të tij si arsimtarë i gjeografisë. Gjthashtu drejtori i atëhershëmi SHF ka nënshkruar edhe kontratë për punësim në kohë të pacaktuar të personit, dhëndërrin e vajzës së tij.

Me datë 16.11.2020 Komisioni shtetëror u drejtuar deri tek SHF dhe kërkoi nga drejtori i shkollës të dorëzojë deklaratë për atë se vallë personi, Sekretar i shkollës së njëjtë jeton në familje së bashku, në kuptim të nenit 8 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Me shkrimin e dorëzuar me datë 04.12.2020, nga ana e shkollës fillore të përmendur është dorëzuar informacion se me Vendim nr. 09-1569/1 me datë 18.11.2020 personit i përfundon mandati i drejtorit në ShF....., pas kërkesë së tij me nr. 09-1560/1 me datë 16.11.2020, dorëzuar deri te arkiva e Komunës së Më pas është dorëzuar edhe Deklarata nga personi e vulosur në noter në të cilën qëndron se personi, asnjëherë nuk ka jetuar në familje të përbashkët, personi i përmendur jeton në shtëpi të veten me vajzën e personit

Përshkak të ndryshimi të gjendjes faktike, gjegjësisht personi, nuk e kryen më detyrën e drejtorit të SHF, Komisioni shtetëror nuk mund të ngre iniciativë për caktim të përgjegjësisë për personin e njëjtë, në përputhje me nenin 17 paragrafi 4 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konflikti të interesave.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vensosi si me dispozitat e këtij vendimi.

Pas përfundimit të KSHPK;

Punoi: S. M., Këshilltarë i lartë

Miratoi: m-r V. G., anëtarë i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Zëvendës-kryetarë: Sofka Pejovska Dojçinovska